



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2246/6 prot.

Datë 08.10.2025

V E N D I M
Nr. 1410 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.10.2025 shqyrtoi ankesën me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49929-06-03-2025, me objekt “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”- Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomik, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër”, me fond limit 33,332,133.44 (*tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e katër*) Lek pa TVSH ose 338,913.4 (*treqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë pike katër*) Euro pa TVSH. Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 02.06.2025, me kurs këmbimi 98.35 Lek, zhvilluar në datën 14-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK dhe “MF

INVEST GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Ankimues:

Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK me NIPT L11807013M dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga Dritan Hoxha, ndërtesa nr. 117, Shkalla nr.2, apartamenti nr. 5/3, Tiranë

BOE “NET-GROUP” SHPK me NIPT L72023002P & “IPSUM.CO” SHPK me NIPT L92225025C & “Viante Konstruksion” SHPK me NIPT K47103804L dhe adresë Rruga Vorpset, pas restorant Piazza, zk 8350, nr. Pasurie 6/187/N2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04-06-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49929-06-03-2025, me objekt “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”- Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomik, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër”, me fond limit 33,332,133.44 (*tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e katër*) Lek pa TVSH ose 338,913.4 (*treqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë pike katër*) Euro pa TVSH. Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 02.06.2025, me kurs këmbimi 98.35 Lek, zhvilluar në datën 14-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2 Në datë 14.07.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 31.07.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- BOE “Taulant” dhe Transport Highëay Consulting” sh.p.k 32’628’180 lekë pa tvsh kualifikuar
- BOE “Grama” dhe “Zenit&Co” SHPK 32’630’000 lekë pa tvsh kualifikuar
- BOE “GB Civil Engineering” dhe “Engineering Consulting Group” SHPK 33’000’000 lekë pa tvsh skualifikuar
- BOE “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK 33’000’000 lekë pa tvsh skualifikuar

- BOE “P.C.S.Company” SHPK dhe “Hydro-Eng Consulting” SHPK 33’297’934 lekë pa tvsh kualifikuar
- BOE “Arkimade” SHPK dhe “E.B.S” SHPK dhe “Noor Engineering” SHPK 33’300’000 lekë pa tvsh kualifikuar
- BOE “Net-Group” SHPK dhe “Viante konstruksion” SHPK dhe “IPSUM.CO” SHPK 33’330’000 lekë pa tvsh skualifikuar

II.4. Në datë 13.08.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 20.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2246/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5713 e bashkimit të operatorëve ekonomik “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2246/1 prot, datë 21.08.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në datën 21.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2259/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5717 e operatorit ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK dhe “MF INVEST GROUP” SHPK.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2259/1 prot, datë 22.08.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK dhe “MF INVEST GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Në datë 29.08.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Durrës ka dërguar nëpërmjet postës elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik në adresën kpp_info@kpp.gov.al aktin e trajtimit të ankesës së BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK, Vendim “Mbi ankesën e ardhur nga operatori ekonomik “C.E.C Group” shpk dhe BOE “Net Group” SHPK & IPSUM.CO shpk & “Viante Konstruksion” SHPK, për procedurën me objekt: “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose përgatitje të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”, protokolluar me tonën me nr. 2246/2 prot., datë 03.09.2025, nga ku konstatohet se ka refuzuar ankesën e BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK dhe ka vensodur si më poshtë vijon:

“[...] Për sa më lart, KSHA, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe DST-së përkatëse,

VENDOSI:

- 1. Refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK në procedurën mbi kufirin e lartë monetar: “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”, me fond limit 33,332,133.44 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e katër) Lek pa TVSH, me fonde nga buxheti i Bashkisë Durrës dhe me numër referencë REF-49929-06-03-2025.*
- 2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “C.E.C Group”, Komisioni i shqyrtimit të ankesave i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Durrës me nr. 232, datë 15.08.2025 ka marrë vendim protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 1298/4., datë 20.08.2025.[..]”*

II.10. Me shkresën me nr. 1298/12 prot., datë 02.09.2025 me lëndë “Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për procedurën me objekt: “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”, protokolluar me tonën e nr. 2246/3 prot., datë 04.09.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Durrës ka ridërguar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK.

II.11. Me shkresën me lëndë “Dërgim ankese”, datë 21.08.2025 operatori ekonomik “C.E.C Group” shpk ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar “Formularin e ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2259/2 prot., datë 25.08.2025.

II.12. Në datë 01.09.2025 operatori ekonomik “C.E.C Group” shpk ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Formularin e Paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2259/3 prot., datë 01.09.2025, nëpërmjet të cilit ngre pretendime lidhur me vendimarrjen e KSHA-së.

II.13. Në datë 01.09.2025 me shkresën me lëndë “Revokim vendimi të AK dhe informacion shtesë mbi ankesë”, protokolluar me tonën me nr. 2259/4 prot., datë 02.09.2025, operatori ekonomik “C.E.C Group” SHPK ka dorëzuar pretendime për kundërshtimin e vendimarrjes së KVO-së dhe KSHA-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të tij me pretendimin se: “..Së pari, përse i përket pretendimit mbi mosparaqitjen e “Shtojcës 5 Deklaratë mbi Disponueshmërinë e Stafit”, theksojmë se ky dokument nuk është kërkuar askund në kriteret e veçanta për kualifikim të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, sikurse duhet të bëhet në çdo procedurë prokurimi ku kërkohet kjo deklaratë, duke u kërkuar specifikisht në ccdo kapitull ku listohet stafi kryesor, stafi mbështetës apo stafi shtesë. Përfshirja e saj si shkak për skualifikim është në kundërshtim me praktikën e konsoliduar, sipas së cilës kriteret për dokumentacion duhet të jenë të qarta, të përcaktuara paraprakisht dhe të kërkuara në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 5 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 5.

(¹Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

¹ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj se:**

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

III.1.2. Neni 3 i LPP-së “Parime të përgjithshme” parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.1.3. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është

e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor,

për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga arsyja e skualifikimit të BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK me arsyetimin se: *“Asnje nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur Shtojcën 5 - Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit”*, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, referuar kritereve të veçanta të kualifikimit nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e posaçme nga ana e autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të paraqesin një Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas shtojcës 5 të dokumentave të tenderit. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit duhet të paraqesin në këtë fazë të procedurës një dokument Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas shtojcës 5 të dokumentave të tenderit. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ofertues është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“[...] Së dyti, në lidhje me certifikatat ISO, është e qartë se këto bëjnë pjesë në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” që duhet të përmbushet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në tërësi, dhe jo detyrimisht nga secili anëtar veccmas. Vetë logjika e bashkimit të operatorëve ekonomikë konsiston pikërisht në faktin se secili sjell kapacitetet e veta për të përmbushur së bashku kriteret e tenderit. Kërkesa që cdo anëtar i bashkimit të ketë individualisht të gjitha certifikatat ISO do ta bënte të panevojshëm vetë institutin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, pasi nëse secili prej tyre duhej të përmbushte plotësisht dhe individualisht të gjitha kriteret e posaçme, atëherë ata mund të konkurronin në mënyrë të pavarur. Një interpretim i tillë do të cconte në pasojë që cdo operator në bashkim të kishte jo vetëm të gjitha certifikatat ISO, por edhe të gjithë stafin e kërkuar, të gjitha pajisjet teknike (p.sh. pajisje topografike), numrin e plotë të punonjësve dhe të gjitha kategoritë e kërkuara për licencat profesionale. Një qasje e tillë është në kundërshtim me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe kuptimit të vetë dispozitës mbi bashkimet e operatorëve ekonomikë, sicc parashikohet edhe në legjislacionin për prokurimet publike”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit, në pikën 2.4.1 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:

- a. ISO 9001: 2015 Për menaxhimin e cilësisë/ose ekuivalente;
- b. ISO 14001: 2015 Për menaxhimin e cilesisë së mjedisit/ose ekuivalente;
- c. ISO 50001:2018 Sistemi i Menaxhimit të Energjisë/ose ekuivalente;
- d. ISO 39001:2012 Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në transportin rrugor/ose ekuivalente;
- e. ISO 45001:2018 Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalente.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.2 Në përmbushje të kriterit të mësipërm BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” shpk dhe “Viante Konstruksion” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Kontratë për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë, datë 07.07.2025 lidhur ndërmjet operatorëve ekonomik “Net-Group” SHPk, IPSUM.CO shpk dhe “Viante Konstruksion” SHPK ku në pikën 4. Pjesëmarrja. 4.1 Pjesëmarrja e Anëtarëve të Grupit e shprehur në fusha/ekspertiza për arritjen e objekteve të kësaj kontrate do të jetë si vijon: *“ndarja e përqindjeve është si më poshtë: 1. Shoqëria “NET-GROUP” shpk 65 % të pjesëmarrjes, 2. shoqëria “IPSUM.CO” shpk 25 % të pjesëmarrjes, 3. shoqëria “Viante Konstruksion” shpk 10 % të pjesëmarrjes.* Ndërsa në pikën 4.2 përcaktohet se: *“Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike do të përmbushen nga i githë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, apo fokusit kryesor të secilit anëtar, të përcaktuara në akt marrëveshje.*
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 9001:2015 për qëllimet e mëposhtëm: Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim të veprave të inxhinierisë civile, certifikata nr. SB.17.0232.05.QMS, data e skadencës 22.10.2026.
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 14001:2015 për qëllimet e mëposhtëm: Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim të veprave të inxhinierisë civile, certifikata nr. SB.17.0233.05.EMS, data e skadencës 22.10.2026.
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 45001:2018 për qëllimet e mëposhtëm: Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim të veprave të inxhinierisë civile, certifikata nr. SB.17.0234.06.OHS, data e skadencës 22.10.2026
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk

është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 dhe zbaton parimet e aneksi SL, shtojca 2 – Direktivat ISO/IEC, Pjesa 1:2018 9i barasvlefshëm me pas 99:2012) për qëllimet e mëposhtëm: Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim të veprave të inxhinierisë civile, certifikata nr. SB.17.0235.06.PAS, data e skadencës 22.10.2026

- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 50001:2018 për qëllimet e mëposhtëm: Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim të veprave të inxhinierisë civile, certifikata nr. SB.17.0236.06.ENM data e skadencës 22.10.2026
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit SA 8000:2014* për qëllimet e mëposhtëm: Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim të veprave të inxhinierisë civile, certifikata nr. SB.17.0237.05.ETH data e skadencës 22.10.2026
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO IEC 20000-1:2018 për qëllimet e mëposhtëm: Sistemi i menaxhimit të shërbimeve IT në mbështetje të shërbimeve të ofruara nga zona operationale e asistencës teknike për klientët e jashtëm për aktivitetet e projektimit, mbikqyrjes dhe kontrollimit të testimit, certifikata nr. SB.18.0149.05.ËSM data e skadencës 26.06.2027.
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 39001:2012 për qëllimet e mëposhtëm: Menaxhimi i logjistikës së personelit për aktivitetet e projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudit të punimeve inxhinierike civile, certifikata nr. SB.18.0227.04.RTS data e skadencës 24.09.2027.
- Dokumentin Certifikatë Regjistrimi lëshuar nga Certi W në emër të shoqërisë NET-Group shpk me anë të së cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i NET-Group shpk është në përputhje me kërkesat e standartit ISO/IEC 27001:2022 për qëllimet e mëposhtëm: Menaxhimi i informacionit dhe të dhënave në lidhje me aktivitetin e projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudit të veprave të inxhinierisë civile. Deklarata e zbatimit REV.6 DT.10.10.24, certifikata nr. SB.18.0013.07.ISM, data e skadencës 18.01.2027.
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të cilësisë me nr. AQS/Q/116182024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 9001:2015, data e skadencës 19.01.2027.
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të mjedisit nr. AQS/A/116192024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 14001:2015 data e skadencës 19.01.2027.
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë nr. AQS/S/116202024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 45001:2018 data e skadencës 19.01.2027.

- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të anti-ryshfetit nr. AQS/AB/118472024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 37001:2016 data e skadencës 03.03.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, nr. AQS/RTS/116212024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 39001:2012 data e skadencës 19.01.2027.
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të integruar, nr. AQS/PAS/116242024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, BS PAS 99:2012 data e skadencës 19.01.2027.
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të integruar, nr. AQS/SA/116322024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, SA 8000:2014 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të integruar, nr. AQS/SI/116312024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO/IEC 27001:2022 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, nr. AQS/SI/116312024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO/IEC 27001:2022 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të energjisë, nr. AQS/GE/116302024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 50001:2018 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, nr. AQS/QS/116232024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 3834-4:2021 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti kërkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike, nr. AQS/QS/116222024 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, UNI EN ISO 3834-2:2006 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti specifikimet për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit, nr. AQS/SSC/116262024, lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 28001:2007 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të qëndrueshmërisë së eventeve, nr. AQS/ES/116272024, lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 20121:2012 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti për shqyrtimin e standarteve Europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit, nr. AQS/SES/116292024, lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, DS CEN/TR 15128:2005 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore nën presion – pjesa 1: të përgjithshme, nr. AQS/PPS/116252024, lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 1452-1:2009 data e skadencës 19.01.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemet për veshjen e kanaleve. Specifikimet e produkteve, nr. AQS/TLS/116282024, lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, BS EN 13331-1:2002, data e skadencës 19.01.2027

- Certifikatë konformiteti, nr. AQS/TL/46962019 lëshuar nga AQScert në emër të shoqërisë Viante Konstruksion SHPK, ISO 3744:2010, data e skadencës 25.10.2019

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të

përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.6. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën

përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.2.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.*

III.2.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e

përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me arsyen e skualifikimit të BOE “Net-Group” shpk “Viante konstruksion” SHPK dhe “IPSUM.CO” SHPK se: “....operatori ekonomik IPSUM.CO, pjese e BOE, nuk ka paraqitur asnje nga certifikatat ISO te kerkuara. KVO”, nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga BOE ekonomik ankimues Komisioni konstaton, se BOE ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e listuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 2.4.1 të shtojcës 9 “Kriteret e veccanta të kualifikimit”, ka përcaktuar se: “**2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:**

- a. ISO 9001: 2015 Për menaxhimin e cilësisë/ose ekuivalente;
- b. ISO 14001: 2015 Për menaxhimin e cilesisë së mjedisit/ose ekuivalente;
- c. ISO 50001:2018 Sistemi i Menaxhimit të Energjisë/ose ekuivalente;
- d. ISO 39001:2012 Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në transportin rrugor/ose ekuivalente;
- e. ISO 45001:2018 Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalente.

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret BOE “Net-Group” SHPK dhe “Viante konstruksion” SHPK dhe “IPSUM.CO” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik datë 07.07.2025, në pikën 4 “Pjesëmarrja”, pika 4.1 përcaktohet se: “*pjesëmarrja e anëtarëve të grupit e shprehur në fusha/ekspertiz për arritjen e objekteve të kësaj kontrate, do të jetë si vijon: shoqëria “Net-Group” shpk 65 % të pjesëmarrjes, shoqëria “IPSUM.CO” SHPK 25 % të pjesëmarrjes, shoqëria “Viante Konstruksion” shpk 10 % të pjesëmarrjes.* Rezulton se operatori ekonomik “IPSUM.CO” SHPK ka marrë përsipër të kryejë 25 % të shërbimeve. Ndërkohë në pikën 4.2 të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se: “*kërkesat ekonomike,*

financiare, profesionale dhe ato teknike do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, apo fokusit kryesor të secilit anëtar, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “IPSUM.CO” SHPK ka marrë përsipër të kryejë vetëm 25 % të shërbimeve. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuara se kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, apo fokusit kryesor të secilit anëtar, të përcaktuara në akt marrëveshje. Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh, dhe në kushtet kur 2 operatorët e tjerë kanë dorëzuar certifikatat ISO të kërkuara nga autoriteti kontraktor, kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.4.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit përmbushet nga i gjithë bashkimi. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe monitorimet përkatëse, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

III.3. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C Group” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku një prej të cilave është edhe kryerja e pagesës së tarifës përkatëse për ankesën, në mbështetje të nenit 120 pika 1 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.3.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ rezulton se në datë 21.08.2025 operatori ekonomik “C.E.C Group” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ankesën me nr. ankimi elektronik A/2025/5717 dhe me nr. 2259/2025 Protokolli, Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ Komisioni konstaton, se në datë 01.09.2025 operatori ekonomik ka ngarkuar në SAE dokumentin bankar që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës financiare për ankesën me nr. 2259/2025 prot., i cili mban datën 29.08.2025. Referuar pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse mungon ndonjë nga

elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”, nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin administrativ Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se që autoriteti kontraktor nuk ka kryer veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës. Si rrjedhojë rezulton se operatori ekonomik “C.E.C Group” SHPK ka vetëkorrigjuar të metat e ankesës përsa i përket kryerjes së pagesës së tarifës financiare dhe dërgimin e dokumentit bankar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se ankesa e dorëzuar pranë KPP-së plotëson kushtin formal për kryerjen e pagesës së tarifës financiare të ankesës.

III.4. Lidhur me pretendimin e OE ankimues “C.E.C GROUP” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të BOE “C.E.C GROUP” SHPK dhe “MF INVEST me arsyetimin se: *“sqarojmë se autoriteti kontraktor në kushet kur periudha e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës është brenda afateve kohore të shqyrtimit të ankesës por e vlefshme edhe deri në përfundim të një vendimarrje të vet Komisionit të Prokurimit Publik, referuar këtu afateve të parashikuara nga ligji për shqyrtimin e ankesës, nuk duhet të kishte disponuar menjëherë me skualifikimin e OE pjesmarrës por nëse e cmonte të nevojshme duhet ti kishte kërkuar atij zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës dhe vlefshmërisë së saj dhe vetëm në rast të refuzimit të zgjatjes së saj mund të skualifikonte ofertën e tij [..]*

[..]ne VKM shprehet qarte qe ne fazen e pare kerkohen vetem dokumentat ligjore dhe ne fazen e dyte kerkohen oferta teknike dhe ekonomike e cila shoqerohet me sigurimin e ofertes pasi ne te kundert do te kerkohej dy here siguriimi ofertes nje here per marrveshjen kuader dhe nje here kur te hapen minikonkurset kjo ne kundërshtim me LPP-se Nr. 162/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK duke rritur shpenzimet per operatore, ulur eficencen , ulur konkurrencen si dhe mos trajtimi ne menyre te barabart e jo diskriminues te operatoreve ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.b të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.4.2. Në shtojcën 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 3.

[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.4.3. Në Seksionin 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, “Njoftimi i kontratës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-

ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e sigurimit të ofertës është 666,643 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) Lek ose 6,778 (gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 02.06.2025, me kurs këmbimi 98.35 Lek.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma, monedha)

Loti 2 _____ (shuma monedha)

3.1.2 Autoriteti/ Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor _____ (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë) ditë

III.4.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin e Sigurimit të Ofertës me Nr.unik {94B26A80-B00C-41E1-BB86-00740124B982}, Nr. i serisë:250603637, në emër të shoqërisë “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK, të lëshuar më datë 14.07.2025, nga shoqëria e sigurimeve “Albsig” SHA për Bashkinë Durrës, si kusht për sigurimin e ofertës së operatorit ekonomik “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore ne

territorin e Bashkis Durrës” Lloji i procedurës së prokurimit: “e hapur”-mbi kufirin e lartë monetar (punë).”, me vlerën 666 643 leke, për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 150 ditë.

III.4.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.4.6. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”*

III.4.7. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”*

III.4.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 9/2 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, të Njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, ku njëra është në formën e garancisë bankare ose tjetra nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente, sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej 666 643 leke, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej **395** ditë.

III.4.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshua. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se

operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C.E.C Group” shpk dhe “MF Invest Group” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar Formularin e Sigurimit të Ofertës me nr. serial 250603637. Konkretisht, referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” të dorëzuar nga BOE “C.E.C Group” shpk dhe “MF Invest Group” SHPK, konstatohet, se ky i fundit është lëshuar në njërën prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga shoqëri të licencuara nga autoritetet kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “Albsig” SHA, ku formulari i sigurimit të ofertës së lëshuar nga kjo shoqëri dhe përkatësisht formulari me Nr. i serisë: 250603637 është sipas Shtojcës 3 të dokumenteve të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe ky formular është sipas vlerës së kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” të dokumenteve të tenderit, por rezulton se dhe afatit të vlefshmërisë i përcaktuar në formularin e sigurimit të ofertës prej 150 ditë nuk është sipas afatit të vlefshmërisë të kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikën 3.2 Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” të dokumenteve të tenderit” të dokumentave të tenderit, përkatësisht 395 ditë. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se formulari i sigurimit të ofertës të paraqitur nga BOE “C.E.C Group” shpk dhe “MF Invest Group” SHPK, është lëshuar nga shoqëria e sigurimeve “Albsig” SHA më datë 14.07.2025 ku është përcaktuar se ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 150 ditë, si dhe në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor përsa i përket periudhës së vlefshmërisë. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik BOE “C.E.C Group” shpk dhe “MF Invest Group” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b të Shtojcës 9/2 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e OE ankimues “C.E.C GROUP” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të BOE “C.E.C GROUP” SHPK dhe “MF INVEST me arsyetimin se: “.....Ne lidhje me pretendimin pasi nje nga kompanite e BoE nuk disponon ISO 39001:2012 arsyetojme: Ligjvënësi ka parashikuar se disa operatorë ekonomik mund të bashkohen dhe të paraqiten si një ofertues i vetëm, pra si një entitet. Por ligjvënësi ka parashikuar dhe disa kriteret që duhet të plotësojë ky entitet në zbatim të nenit 88 të VKM Nr. 285/2021. Autoret Kontraktor gabon rëndë, kur kërkon që cdo kriter duhet të përmbushet nga secili prej anëtarë në raport me zërat e punimeve të marra përsipër pasi së pari kjo bie ndesh me dispozitat e ligjit në të cilët shpjegohet qartë se në këtë rast (pra të bashkimit të OE) jemi përpara një ofertuesi të vetëm si dhe bie ndesh dhe me parashikimet dhe të drejtat dhe detyrimet që palët kanë parashikuar në kontratën e bashkëpunimit. JU SI AK DUHET TE KISHIT SHKEMBYER NJE KORESPONDENCE ME KOMPANINE QE BENE CERTIFIKIMET DHE NE BAZE TE NJE PERGJIGJEJE MUND TE DILNIT NE KONKLuzion JO TE VEPRONI NE KETE MENYRE DUKE CENUAR RENDE INTERESAT TONA DERI DIKU DHE JO SHUME TE BAZUARA NE LIGJ PER TE VETMIN FAKT QE DUHET TE SKUALIFIKOHEMI. Ne lidhje me kete ne po ju paraqesim dhe korespondencen e faturen e cila eshte e dates 03.06.2025 (pra nje muaj e

gjyse perpara se te behej procedura) ne lidhje me vlefsherine e kesaj ISO qe ju pretendoni qe eshte e skaduar. Për rrjedhojë pretendimi i AK nuk qëndron”, Komisioni i Prokurimit publik vëren se,

III.5.1 Në shtojcën 9 “kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit, në pikën 2.4.1 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:

- a. ISO 9001: 2015 *Për menaxhimin e cilësisë/ose ekuivalente;*
- b. ISO 14001: 2015 *Për menaxhimin e cilesisë së mjedisit/ose ekuivalente;*
- c. ISO 50001:2018 *Sistemi i Menaxhimit të Energjisë/ose ekuivalente;*
- d. ISO 39001:2012 *Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në transportin rrugor/ose ekuivalente;*
- e. ISO 45001:2018 *Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalente.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.5.2 Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit BOE “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Kontratë Bashkëpunimi (Për bashkimin e operatorëve ekonomik), datë 04.07.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë C.E.C Group SHPK dhe shoqërisë “MF Invest Group” SHPK ku në pikën “Pjesëmarrja” përcaktohet ndarja sipas natyrës së punëve që do të realizojë secili. Gjithashtu përcaktohet se: *“Palët bien dakord të paraqiten si bashkim operatorësh dhe të ofertojnë duke dorëzuar ofertë, për kryerjen e punimeve sipas raportit të mësipërm dhe sipas kapaciteteve tekniko-financiare që ata deklarojnë për prokurimin e procedurës së mësipërme në rast të kualifikimit dhe të shpalljes fitues. Palët bien dakort se do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitete financiare/ekonomike, profesionale dhe ato teknike si dhe eksperiencën e tyre, si një grup i vetëm pavarësisht nga pjesëmarrja, për realizimin sa më të mirë të kontratës”.*
- Certifikatë konformiteti për menaxhimin e cilësisë, me nr. AQS/Q/121812024 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest group” SHPK, standardi ISO 9001:2015, data e skadencës 22.04.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të mjedisit, me nr. AQS/A/121822024 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest Group” SHPK, standardi ISO 14001:2015, data e skadencës 22.04.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, me nr. AQS/S/121832024 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest Group” SHPK, standardi ISO 45001:2018, data e skadencës 22.04.2027

- Certifikatë konformiteti për sistemet e menaxhimit të energjisë me nr. AQS/GE/95922022 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest Group” SHPK, standardi ISO 50001:2018, data e skadencës 22.12.2025
- Certifikatë konformiteti për sistemet e menaxhimit të sigorisë së informacionit me nr. AQS/SI/90472022 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest Group” SHPK, standardi ISO/IEC 27001:2022, data e skadencës 31.07.2025
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigorisë në trafikun rrugor me nr. AQS/RTS/88892022 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest Group” SHPK, standardi ISO 39001:2012, data e skadencës 20.06.2025.
- Certifikatë konformiteti për kërkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike me nr. AQS/QS/112392023 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “MF Invest Group” SHPK, standardi EN-ISO 3834-2:2021, data e skadencës 10.11.2026.
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të integruar, me nr. AQS/PAS/110492023 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi BS PAS 99:2012, data e skadencës 23.10.2026
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të cilësisë, me nr. AQS/Q/117192024 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO 9001:2015, data e skadencës 12.02.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të mjedisit, me nr. AQS/A/117202024 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO 14001:2015, data e skadencës 12.02.2027
- Certifikatë konformiteti për teknologjinë e informacionit – menaxhimi i shërbimit, me nr. AQS/IT/85702022 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO/IEC 20000-1:2018, data e skadencës 18.04.2025
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigorisë së informacionit, me nr. AQS/SI/103802023 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO/IEC 27001:2013, data e skadencës 02.06.2026
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigorisë në trafikun rrugor, me nr. AQS/RTS/110482023 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO 39001:2012, data e skadencës 23.10.2026
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, me nr. AQS/S/117212024 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO 45001:2018, data e skadencës 12.02.2027
- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, me nr. AQS/GE/110472023 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO 50001:2018, data e skadencës 23.10.2026

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat*

e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të

përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efijencës së energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.5.6. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.5.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm

gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.5.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.5.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e

përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me arsyen e skualifikimit të BOE “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK se: “....*certifikata ISO 39001:2012 e MF Invest Group (pjesë e BOE), rezulton e skaduar (data e skadences 20.06.2025)*”, nga verifikimi i dokumentave të tenderit, si dhe dokumentave të dorëzuara në SPE nga BOE “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK Komisioni konstaton, se BOE ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e listuar në pikën III.5.2 të këtij vendimi. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 2.4.1 ka përcaktuar se: **2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:**

- a. ISO 9001: 2015 *Për menaxhimin e cilësisë/ose ekuivalente;*
- b. ISO 14001: 2015 *Për menaxhimin e cilesisë së mjedisit/ose ekuivalente;*
- c. ISO 50001:2018 *Sistemi i Menaxhimit të Energjisë/ose ekuivalente;*
- d. ISO 39001:2012 *Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në transportin rrugor/ose ekuivalente;*
- e. ISO 45001:2018 *Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalente.*

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret BOE “C.E.C Group” SHPK dhe “MF Invest Group” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.5.2 të këtij vendimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit për bashkimin e operatorëve ekonomikë datë 04.07.2025, në pikën “Pjesëmarrja” vihet re se operatorët ojesëmarrës në bashkim kanë përcaktuar pjesëmarrjen në këtë bashkim sipas natyrës së punëve që do të kryejnë, gjithashtu po në këtë pikë përcaktohet se: “palët bien dakort se do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitete financiare/ekonomike, profesionale dhe ato teknike si dhe eksperiencën e tyre si një grup i vetëm pavarësisht nga pjesëmarrja për realizimin sa më të mirë të kontratës. Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar arsyes së skualifikimit si dhe dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar një certifikatë ISO 39001:2012 *Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në transportin rrugor/ose ekuivalente*, edhe pse certifikata ISO e operatorit ekonomik “MF Invest group” shpk anëtar i BOE rezulton e skaduar në datë 20.06.2025, kriteri për këtë certifikatë plotësohet me

Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, me nr. AQS/RTS/110482023 lëshuar nga AQScert, për shoqërinë “C.E.C Group” SHPK, standardi ISO 39001:2012, data e skadencës 23.10.2026 e dorëzuar nga operatori ekonomik “CEC Group” shpk anëtar i BOE. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuar se palët bien dakort se do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitete financiare/ekonomike, profesionale dhe ato teknike si dhe eksperiencën e tyre si një grup i vetëm pavarësisht nga pjesëmarrja për realizimin sa më të mirë të kontratës. Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh, dhe në kushtet kur operatori C.E.C Group SHPK anëtar i BOE ka dorëzuar certifikatat ISO të kërkuara nga autoriteti kontraktor, kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.4.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit përmbushet nga i gjithë bashkimi. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe monitorimet përkatëse, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Net-Group” SHPK & “IPSUM.CO” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49929-06-03-2025, me objekt “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe

- infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës” me fond limit 33,332,133.44 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga OE “*C.E.C Group*” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.
 3. Autoriteti Kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “*Net-Group*” SHPK & “*IPSUM.CO*” SHPK & “*Viante Konstruksion*” SHPK.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga OE “*C.E.C GROUP*” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

